



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:123654

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05712861

P.nr. 135/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të pandehurit E. T., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.415/2024, të datës 23.04.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 21.05.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Nazmi Krasniqi dhe i pandehuri, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

E. T., nga i ati R. dhe e ëma S. e gjinisë K., i lindur me datë ..., në P., tani me vendbanim me në rr.“Ll.”, pa nr, K-P., ka te kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve, punëtor sigurimi, me nr. Personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se nga data e pa vërtetuar e gjerë me datë 01.12.2023 në shtëpinë e tij ne P., i pandehuri E. T. me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, pa autorizim ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollës së bëre nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, në datën e lartcekur është konstatuar se i pandehuri, në njehsorin elektrik me numër ... konsumatori daljet e njehsorit i ka

vendosur ne hyrje me c ‘rast energjia elektrike e shpenzuar nuk është matur, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS-Distrikti në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

- **Me çka i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 40, 43, 69, 70 dhe 314 të KPRK, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 368, 369 dhe 452 të KPPRK e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumën prej **njëqind (100) Euro**, të cilën i pandehuri detyrohet t’u paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, atëherë ky dënim me gjobë do t’i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do ti caktohet një (1) ditë burgim.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro ndërsa në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimet po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

IV. E dëmtuara KEDS - Divizioni Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.415/2024, të datës 23.04.2024, kundër të pandehurit E. T., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.05.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të njëjtit në kuptim të nenit 241 par.4 të KPPRK-së i ofrojë mundësinë e deklarimit të tij rreth fajësisë-të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: E pranoj fajësinë, premtoj se do të i paguaj të gjitha shpenzimet dhe nuk do të kemi më asnjë problem lidhur me këtë rast e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, jam mbajtës i familjes dhe jetoj në kushte të rënda.

Gjykata vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit ka dhënë mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe deklaroi se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar në shkresat e lëndës..

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par. 2 të KPPRK-së, aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 par. 6 të KPPRK-së vazhdoi me shqyrtimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit përmbushen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin e paraparë ligjor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka premtuar se nuk do ta përsëris më veprën, është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ndonjë ekspertizë nga ndonjë ekspert i pavarur për vlerësimin e dëmit, andaj mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil, pasi që gjykata nuk ja fali besimin, vlerësimin e dëmit vetëm nga pala e dëmtuar për shkak se nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2024:123654
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05712861

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr. 135/24, dt. 21.05.2024.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.